



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.851/ 6 prot

Datë 22.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 529 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.04.2026 me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Shërbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK, me NIPT L92713601Q, Adresa: *Lagjja 18 Shtatori, Rr. Xhorxh Sorros, nr. 1524, Gjirokastër.*

Operatori ekonomik Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me Nipt J62426002Q, Adresa: *Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.  
Adresa: *Rruga 5 Maji, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, informacionin e autoritetit kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesa nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.5. Operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.03.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Sherbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6432 datë 14.03.2026 dhe me Nr. 851/2026 Prot., datë 17.03.2026, nga operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë.

II.4. Me shkresën nr. 1156/9 prot, datë 24.03.2026, protokolluar me tonën me nr.851/1, datë 25.03.2026, Autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “IN PRINT” ShPK, për djeni KPP-në, Mbi korigjimin e të metave të ankesës, e cila është pa pagesë.

II.5. Me shkresën nr. 851/2 prot, datë 31.03.2026, me objekt: *Kërkesë për Informacion*, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Sektorit të Financës pranë KPP-së, kërkoi informacion mbi statusin aktual të pagesës, për ankesën me Nr. 851/2026 Prot., datë 08.07.2025, nga operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK.

II.6. Me shkresën nr.851/3 prot, datë 03.04.2026, me objekt: Kthim përgjigje, Sektorit i Financës pranë KPP-së, Informon:

*[...] Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 851/2 prot., datë 31.03.2026, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.851/2026 Prot., datë 17.03.2026, dhe me nr. Ankimi elektronik me nr. A/2026/6432 datë 14.03.2026 Operatori Ekonomik “IN PRINT” ShPK nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen për tarifën e ankimimit. Referuar raportit të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 31.03.2026 rezulton se, Operatori Ekonomik “IN PRINT” ShPK nuk ka kryer pagesë për ankesën në favor të Komisionit të Prokurimit Publik.*

II.7. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr A/2026/6434, datë 17.03.2026 dhe me Nr. 858/2026 Prot., date 17.03.2026 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Sherbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit sipërcituar.

II.8. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.9. Me shkresën me nr. 858/1 Prot, datë 01.04.2026, Kërkesë për Informacion, drejtuar AK-së, Komisioni kërkoi nga AK të shqyrtojë ankesën dhe të përcjellë Vendimin e KSHA-së.

II.10. Autoriteti Kontraktor me shkresën ardhur në sistem me Nr. 1156/11 prot., datë 01.04.2026, protokolluar me tonën me Nr. 858/2 , datë 01.04.2026, si edhe me shërbim postar protokolluar me numrat 858/3, datë 02.04.2026 dhe nr. 858/4, datë 03.04.2026, ka përcjellë Vendimin e KSHA-së, Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.

Referuar shkresës së autoriteti kontraktor, me anë të së cilës informon, se KSHA ka vendosur pranimin pjesërisht të pretendimeve mbi modifikim të kriterëve dhe specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit.

II.11. Me shkresën ardhur pranë KPP-së me objekt: *Argumente kundërshtuese shitesë*, referuar Vendimit KSHA-së, me nr. 1156/11 Prot., datë 01.04.2026, nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK i cili ka kundërshtuar vendimin e KSHA-së, Mbi mospranimin e pjesëshëm të pretendimeve të ngritura në ankesë.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit të procedurës së prokurimit si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “IN PRINT” ShPK për modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni vëren se:

Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se operatori ekonomik ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.1.1. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, është parashikuar se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*

*4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”*

Gjithashtu në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, është parashikuar se:

*“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”.*

III.1.2. Komisioni referuar dokumentacionit të ankesës, konstaton se Autoriteti kontraktor ka përcjellë shkresën me nr. 1156/9 prot., datë 24.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 851/1, datë 25.03.2026, drejtuar operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK dhe për dijeni KPP-së, me anë të të cilës kërkon nga operatori ekonomik plotësimin e mangësive të formularit të ankesës përsa i përket mandat pagesës.

III.1.2.1. Në vijin të trajtimit të ankesës, me shkresën nr. 851/2 prot, datë 31.03.2026, me objekt: *Kërkesë për Informacion*, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Sektorit të Financës pranë KPP-

së, kërkoi informacion mbi statusin aktual të pagesës, për ankesën me Nr. 851/2026 Prot., datë 08.07.2025, nga operatori ekonomik "INPRINT" ShPK.

III.1.2.2. Me shkresën nr.851/3 prot, datë 03.04.2026, me objekt: Kthim përgjigje, Sektorit i Financës pranë KPP-së, Informon:

*[...] Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 851/2 prot., datë 31.03.2026, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.851/2026 Prot., datë 17.03.2026, dhe me nr. Ankimi elektronik me nr. A/2026/6432 datë 14.03.2026 Operatori Ekonomik "IN PRINT" ShPK nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen për tarifën e ankimimit. Referuar raportit të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 31.03.2026 rezulton se, Operatori Ekonomik "IN PRINT" ShPK nuk ka kryer pagesë për ankesën në favor të Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.1.3.Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se në legjislacionin e prokurimeve publike janë përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor.

Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar shkresave të mësipërme rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, për ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën me nr. ankimi elektronik A/2026/6432 datë 14.03.2026 dhe me Nr. 851/2026 Prot., datë 17.03.2026, nga operatori ekonomik "IN PRINT" ShPK, duke përcjellë shkresën me nr. 1156/9 prot., datë 24.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 851/1, datë 25.03.2026, drejtuar operatorit ekonomik "IN PRINT" SHPK dhe për dijeni KPP-së, me anë të të cilës kërkon nga operatori ekonomik plotësimin e mangësive të formularit të ankesës përsa i përket mandat pagesës.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik drejtuar Sektorit të Financës pranë KPP-së, kërkoi informacion mbi statusin aktual të pagesës për ankesën me Nr. 851/2026 Prot., datë 17.03.2026, nga operatori ekonomik "IN PRINT" SHPK, nga ku rezultoi se ankimesi nuk ka kryer pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e tij.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër

parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar shkresave sipërcituar, dërguar nga autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik, mbi korigjimin e të metave të ankesës, në vijim të shqyrtimit të ankesës si edhe kreu verifikime nga sektori i financës mbi pagesë për ankesën e operatorit ekonomik, si edhe refeuar Sistemit Elektronik të Ankesave konstatoi se ankimuesi “IN PRINT” SHPK nuk ka depozituar dokumentin mandat-pagesë për ankesën me Nr. A/2026/6432 datë 14.03.2026 dhe me Nr. 851/2026 Prot.

Komisioni, referuar fakteve gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep Ligji për të korigjuar një prej elementeve formale të domosdoshëm të ankesës, vënë në dijeni nga autoritetit kontraktor.

Fakti që operatori ekonomik ka refuzuar ndreqjen e të metave, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit.

Referuar arsyetimit më sipër, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës edhe pse ka qenë në dijeni, ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj bazuar në germën “a”, të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kjo ankesë nuk pranohet.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, me argumente si vijon:

*Në lidhje me kërkesat e AK-së të përcaktura në shtojcën 6 (FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE) me përmbajtjen si vijon: Specifikimet teknike per pajisjet dhe qe do te perdoren ne kete procedure.*

**KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Model: Copier, Printer, Scanner**

*Shpejtësia Copy/Print Speed for A4 B&W:*

*Software = 30 ppm Portal Web online për monitorimin në rrjet, monitorimin në distancë nëpërmjet Web-it dhe gjenerimin në mënyrë automatike të counter-ave.*

*Pjesët duhet te jene te reja.*

**KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Model: Copier, Printer Shpejtësia Copy/Print Speed for A4 B&W:**

*Software = 40 ppm Portal Web online për monitorimin në rrjet, monitorimin në distancë nëpërmjet Web-it dhe gjenerimin në mënyrë automatike të counter-ave. Pjesët duhet te jene te reja .. ,*

*Parashitje kundërshtimet tona si më poshtë vijnë: Në specifikimet teknike të hartuara nga AK-ja për 2(dy) llojet e paisjeve që kërkohen për këtë procedurë prokurimi, përvec parametrave teknike është përcaktuar edhe kërkesa për Software, pra për Portal Web online për monitorimin në rrjet, monitorimin në distancë nëpërmjet Web-it dhe gjenerimin në mënyrë automatike të counter-ave.*

Portali Web nuk është pjesë e specifikimeve teknike të pajisjeve të printimit. Pajisjet e printimit janë komponenti hardëare i shërbimit të kërkuar dhe portali Web është pjesa softëare e shërbimit.

*Nuk mund të vendosen në specifikimet teknike të pajisjeve edhe specifikimet softëare, duke qenë që këto janë dy komponentë të ndryshëm të shërbimit. Jo domosdoshmërisht operatorët ekonomikë mund*

të sjellin software të prodhuar nga prodhuesi i pajisjeve, por mund të sjellin edhe softëare të zhvilluara nga palë të treta të përshtatshme për tu përdorur me modele të ndryshme pajisjesh. Vendosja e specifikimeve teknike softëare në të njëjtën kategori me specifikimet teknike të pajisjeve të printimit do të ngushtonte në mënyrë artificiale garën, duke detyruar operatorin ekonomik të ofertojë vetëm me softëare të prodhuar nga prodhuesi i pajisjeve.

Për më tepër, nëse operatori ekonomik do të ofronte me brande të ndryshme pajisjesh printimi, atëherë ai do të ishte i detyruar të sillte softëare të ndryshëm për secilin brand pajisjesh të ofruara. Qëllimi i AK-së është që të sigurojë Portal Web online për monitorimin në rrjet, monitorimin në distancë nëpërmjet Web-it dhe gjenerimin në mënyrë automatike të counter-ave dhe për të nuk është e rëndësishme që ky portal ëeb të jetë detyrimisht i prodhuar nga prodhuesi i pajisjes. Një kërkesë e tillë është tërësisht e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit dhe që kufizon pjesmarrjen e OE-ve në këtë tender. **Në procesverbalin e hartimit të dokumentave nga njësia e prokurimit nuk ka asnjë argument se përse është e rëndësishme që portali web për monitorimin në rrjet të jetë detyrimisht i prodhuar nga prodhuesi i pajisjes. Për të gjitha sa më lart, kërkojmë që Specifikimi teknik i software-it të hiqet nga specifikimet teknike të pajisjeve dhe të vendoset si specifikim teknik më vete, jo i lidhur me specifikimet teknike të pajisjeve.**

III.2.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin Nr. 1156/11 Prot., datë 01.04.2026 e KSHA-së ka pranur pjesërisht pretendimin e ngritur në pikën e parë të ankesës me argument:

**Se pari**, AK duke qene se po prokuron sherbim printimi, e ka te domosdoshme te kete ne dispozicion mjetet e nevojshme softuerike per te monitoruar dhe matur ne menyre te qenderzuar dhe adekuate treguesit sasiorë dhe cilësore te sherbimit te printimit. Prandaj kerkesa per paraqitjen e nje portali ueb apo nje zgjidhje ueb online per monitorimin dhe matjen e sasive te printimit fotokopjimit, pra te sherbimit te printimit, eshte nje kerkese e drejte ne parim. Duke qene se po kontraktohet nje operator ekonomik per kryerjen e sherbimit, eshte e drejte qe fumizimi me pajisje, tonera, konsumabla, menaxhimi i operacionit ne teresi, sherbimi, servisimi, niveli i SLA dhe softueri i matjes se sherbimit, ti ngarkohet operatorit ekonomik qe do te kontraktohet. Ne kete kuptim, duke qene se mbi rezultatet qe gjeneron softëare, Komisioni per ndjekjen e kontrates per AK do te monitoroje zbatimin e kontrates, eshte e drejte nevoja per perfshirjen e nje portali ëeb per matjen e qenderzuar te sherbimit.

**Se dyti**, po ashtu gjykon se portali ëeb duhet qe te tregojë dhe mase se kohe reale sherbimin e printimit e fotokopjimit. **AK ne asnje moment nuk ka cituar qe software te jete i prodhuar prodhuesi i pajisjes dhe nuk eshte e nevojshme qe portali web te jete i prodhuar nga i njejti prodhues i pajisjeve te printimit apo nje portal ëeb specifik.**

ASHA gjykon qe portali web te raportojë sasine e sakte te sherbimit te kryer nga secila pajisje e instaluar, pavaresisht markes apo modelit te pajisjes, dhe te jete i integrueshem me pajisjet e ofertuara. Eshte pergjegjesi e operatorik ekonomik ofrimi i nje portali qe permbush specifiket e kerkuara ne DST ne menyre qe te garantojë cilësi, eficence dhe transparence per te gjitha hallkat e perfshira ne process, pergjate periudhes se ofrimit te sherbimit sipas kerkesave te AK-se per kete procedure prokurimi, objekt shqyrtimi. Per autoritetin kontraktor ka rendesi vetem realizimi i funksionit, i cili eshte i domosdoshem per kontrollin e sakte te volumit te punes, te niveleve te tonerit dhe materialeve konsumuese per secilen pajisje, monitorimin ne kohe reale te kopjeve te printuara te ndara sipas periudhes kohore, dhe shmangien e nderhyrjeve manuale qe mund te cenojne saktësinë dhe transparencën. Referuar arsytimit te mesiperm dhe pretendimeve te OE-se,

KSHA gjykon qe pretendimi i OE qendron pjesërisht pasi per:

Zërin Software - Portal Web online per monitorimin ne rrjet, monitorimin ne distance nepërmjet Web-it dhe gjenerimin ne menyre automatike te counter-ave, duke marre parasysh dhe interpretimin e mesiperm te ASHA, ne menyre qe kerkesat e AK te jene te qarta per te gjithë operatorët ekonomike qe kane interes te paraqesin oferte .

Pajisja e ofertuar duhet te jete e integrueshme me Portalin Web i Menaxhimit dhe Monitorimit të ofertuar.

Pretendimi qëndron pjesërisht.

III.2.2. Në lidhje me pretendimin mbi modifikim: në pikën 3 të kapacitetit teknik të shtojcës 9 të DT-së, me përmbajtjen si më poshtë: ...

3. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 4 (katër) punonjës duke paraqitur vërtetim për numrin e punonjësve në periudhën e hapjes së ofertave si dhe listëpagesat e miratuara për te njejtën periudhë nga të cilët:

**Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT.**

Të paktën 2 (dy) specialistë teknik të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit që OE do të ofertojë;

Të paktën 1 (një) specialistë, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformes së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë;

Për punonjësit, me profesionin si mësipër, duhet të paraqesi: Diplomë/dëshmi kualifikimi sipas profilit, Kontratë individuale pune të vlefshme, Listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit, ku të figurojnë të regjistruar..... , e kundërshtojmë me argumentat si më poshtë:

**SË PARI:** Konkretisht, referuar natyrës së shërbimit që kërkohet të prokurohet është vendosur një numër minimal prej 3 punonjësish me profil pune mekanik dhe elektrik, të kategorisë teknik i mesëm ose inxhinier.

Ankesa jonë lidhet me kërkesën e AK-së që operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 4 (katër) punonjës....., nga të cilët, **të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT.**

Referuar procesverbalit të hartimit të dokumentave, rezulton se nga njësia e prokurimit nuk është dhënë asnjë argument se përse është e nevojshme që pjesë e stafit të jetë të paktën edhe 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT.

**nuk i përket aspak kategorisë teknik i mesëm etj. Certifikimet ITIL lëshohen për personat në fushën e IT-së, të cilët janë të përgatitur për të kryer ndryshime strategjike në infrastrukturën IT, dizejimin dhe implementimin e shërbimeve të reja IT,**

Ndërkohë, procedura objekt ankimi është procedurë shërbim printimi, ku nuk kërkohet që operatori ekonomik të bëjë ndryshime në infrastrukturën IT. Ky është një kriter i cili e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedure prokurimi ul konkurrencën, dhe nuk është në proporcion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, ndaj

**Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter e duke hequr nga pika 3 e kapacitetit teknik të shtojcës 9 të DT-së, kërkesën për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT.**

Me vendimin e ASHA-se Autoriteti kontraktor pasi konsultoi DST, Kriteret e vecanta për kualifikim, arsyeton se pretendimi i ankimesit Qëndron.

III.2.3. Referuar Nenit 30 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Neni 115 pika 1 dhe 3 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”*

III.2.4. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik si edhe Vendimit të KSHA-së, mbi pranimin e pretendimeve në pikat e dy dhe katër të ankesës, Komisioni do të mbyllë shqyrtimin e pjesës së pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Sherbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas vendimit të KSHA-së.

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të ngritura në ankesë.

III.3. Në lidhje me kërkesat e AK-së, të përcaktuara në shtojcën 6 (FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE) me përmbajtjen si vijon:

*...Të gjithë tonerët duhet të jenë origjinalë ose ekuivalentë të certifikuar, të prodhuar nga marka të njohura ndërkombëtare. Për tonerët ekuivalentë duhet të paraqitet dokumentacion certifikues që vërteton se janë prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare për përdorim në ambiente zyre, konkretisht:*

***o ISO/IEC 19752 standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer bardhë e zi;***

***o ISO/IEC 19798 standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer me ngjyra....** , paraqesim kundërshtimet tona: Procedura e prokurimit objekt i këtij ankimi është një procedurë për shërbim printimi, ku AK faturohet mbi bazën e numrit të faqeve të printuara, dhe kapaciteti apo rendimenti i konsumablave të pajisjeve të printimit nuk ndikon në*

koston e autoritetit kontraktor. **Certifikimet ISO të kërkuara nga autoriteti kontraktor do të ishin të pranueshme nëse kjo do të ishte një procedurë për blerjen e konsumablave, ku AK duhet të jetë i sigurt për kapacitetin dhe rendimentin e konsumablave që do të blinte.** Në rastin konkret një kërkesë e tillë për tonerët ekuivalentë duhet të paraqitet dokumentacion certifikues që vërteton se janë prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare për përdorim në ambiente zyre, konkretisht, ISO/IEC 19752 standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer bardhë e zi dhe ISO/IEC 19798 standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer me ngjyra, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, me llojin e procedurës që në rastin konkret është e hapur e thjeshtuar dhe jo në proporcion me vlerën e saj. Sic e theksuam më lart procedura objekt i këtij ankimi është shërbim printimi dhe jo blerje malli. qëllimi i prokurimit është që AK-ja të përfitojë shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit të dokumentave, me anë të pajisjeve, tonerave të vënë në dispozicion nga ofertuesi dhe në cdo rast është në detyrimin e këtij të fundit të garantojë që ky shërbim të funksionojë 24 ore në ditë. Pra është në detyrën e ofertuesit të vëndosë në dispozicion të AK-së, pajisje të cilat duhet të plotësojnë parametrat teknike të përcaktuara nga AK-ja që duhet të jenë funksionale 24 ore në ditë, tonerat gjatë gjithë kohës dhe ti përgjigjet AK-së brenda fatit të përcaktuar për riparimin e difekteve të mundshme të pajisjeve. Për sa kohë operatori ekonomik do të paguhet për cdo faqe te printuar, fotokopjuar, atëherë kërkesa për standarte të caktuara që duhet të plotësojnë tonerat është e ekzagjeruar, gjithmonë duke marrë në konsideratë dhe vlerën dhe llojin e procedurës së prokurimit.

Për gjithë sa më sipër, kërkojmë që të hiqet kërkesa që : ...Për tonerët ekuivalentë duhet të paraqitet dokumentacion certifikues që vërteton se janë prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare për përdorim në ambiente zyre, konkretisht: ISO/IEC 19752 standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer bardhë e zi; ISO/IEC 19798 standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer me ngjyra. , si një kërkesë është tërësisht e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit dhe që kufizon pjesmarrjen e OE-ve në këtë tender.

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST , Shtojca 6, Formulari i Specifikimeve Teknike

- Të gjithë tonerët duhet të jenë origjinalë ose ekuivalentë të certifikuar, të prodhuar nga marka të njohura ndërkombëtare. Për tonerët ekuivalentë duhet të paraqitet dokumentacion certifikues që vërteton se janë prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare për përdorim në ambiente zyre, konkretisht:  
ISO/IEC 19752 – standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer bardhë e zi;  
ISO/IEC 19798 – standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer me ngjyra.

Referuar Proces-verbalit mbi Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike, konstatohet se për kërkesën objekt ankimi Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e saj.

III.3.2. Neni 21 pikat 1-4, “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.3. Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, indryshuar parashikon shprehimisht se:

1. *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

c) *kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

III.3.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.5. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i

vlërëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara në funksion të realizimit të procedurës së prokurimit. Referuar dokumenteve të procedurës si edhe ankesës për kundërshtimin e kërkesës së vendosjes së certifikimeve ISO për tonerat që do të përdoren për shërbimin e kërkuar, Komisioni nga shqyrtimi i DST konstaton se AK ka kërkuar Certifikatat ISO/IEC 19752 – standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer bardhë e zi; ISO/IEC 19798 – standard ndërkombëtar për kapacitetin dhe performancën e tonerëve për printera lazer me ngjyra. Per Tonerat.. Gjithashtu në Shtojcën 9, pika 4, AK ka kërkuar ISO 9001-2025 ose ekuivalente, Për shërbimin.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfitues direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për shërbimin që kërkon, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, të jenë të argumentuara dhe në funksion të objekti dhe qëllimit të procedurës së prokurimit në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

III.3.6. Referuar ankesës së operatorit ekonomik mbi heqjen e kërkesës që operatorët të paraqitin dokument certifikues që tonerat ekuivalentë të jenë prodhuar sipas standardeve ISO, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfitues direkt i kontratës objekt-prokurimi, është përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet ti përmbushin kërkesat e cilësisë për mallrat/shërbimin, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit.

Procedura e prokurimit është Shërbim printimi jo Blerje Tонера që Autoriteti kontraktor të kërkojë Certifikata ISO përpos specifikimet teknike mbi cilesinë e tyre. Komisioni gjykon se vendosja e specifikimevet mbi ISO për tonerat objekt ankimi është një kërkesë e tepërt dhe joproporcionale në procedurën e prokurimit, Shërbim Printimi, ku furnizimi me tonera është një detyrë e operatorit ekonomik duke siguruar tonera origjinalë apo ekuivalentë/kompatibël cilësorë, të pakeluar me elementë sigurie sipas specifikimeve, që tonerat të jenë origjinalë ose ekuivalentë të certifikuar, të prodhuar nga marka të njohura ndërkombëtare, kërkesa mëse të mjaftueshme për procedurën e prokurimit.

Komisioni në analizë të dokumenteve të tenderit gjykon se Kërkesa objekt ankimi Për tonerët ekuivalentë duhet të paraqitet dokumentacion certifikues që vërteton se janë prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare për përdorim në ambiente zyre..sipas ISO është e tepërt duke ndikuar në kosto dhe vështirësi të operatorëve që do të ofrojnë shërbim me pajisje printim/fotokopjimi.

Komisioni thekson që autoriteti kontraktor, në varësi të objektit të kontratës përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, por kërkesa mbi ISO për Tonerat si pjesë e furnizuese të shërbimit të kërkuar është kërkesë joproporcionale me objektin e prokurimit.

Komisioni gjykon se Autoriteti kontraktor ka vendosur kërkesa të tepërta të ekzagjeruar dhe të pa argumentuar qartë, referuar “Proces-verbalit mbi argumentimin e kriterëve për kualifikim” ku AK nuk është shprehur se përse janë të nevojshme dhe si ndikojnë këto certifikata ISO për këtë

procedurë prokurimi e cila nuk është Blereje Tонера por Shërbim printimi, ku operatori është përgjegjës për furnizimin me pajisje e tij dhe pjese konsumable të nevojshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar, i cili duhet të jetë në funksion të punës dhe të sigurojë autoritetin për mosndërprerje të proceseve të printimit/fotokopjimit duke furnizuar rregullisht atë.

Përsa më sipër argumentuar Komisioni gjykon të drejta pretendimet e ankimuesit dhe Autoriteti kontaktor duhet të modifikojë shtojcën 6, duke hequr kërkesën objekt ankimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi kundërshtimin e kërkesës së AK-së të përcaktur në shtojcën 6 (FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE) me përmbajtjen si vijon: ...

*[...]Pjesët duhet të jene të reja, paraqesim kundërshtimet tona si më poshtë vijojnë: **Shërbimi i kërkuar nga ana e autoritetit është shërbim printimi dhe jo blerje pajisjesh printimi.***

***Kërkesa që pjesët të jenë të reja është një specifikim teknik i tepruar, i cili nuk i shërben objektit të kontratës dhe kufizon konkurrencën, duke përjashtuar nga njëra anë operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë akses për të blerë pjesë të reja, por të përdorura dhe nga ana tjetër shton kostot e ofertës në mënyrë të panevojshme pasi, për AK-në është e rëndësishme që të marrin shërbimin e printimit, fotokopjimit dhe të skanimit të dokumentave në mënyrë të pandërprerë dhe për të nuk është e rëndësishme nëse pjesët do të jenë të reja apo të përdorura, për sa kohë që është në detyrimin e ofertuesit të garantojë shërbimin në mënyrë të pandërprerë. Nisur nga natyra e objektit të prokurimit, kërkesa që pjesët të jenë të reja është e ekzagjeruar, shton kosto të panevojshme. në këtë lloj procedurë prokurimi kur edhe pajisjet që i vihen në dispozicion AK-së mund të jenë të përdorura, është e ekzagjeruar të kërkojë pjesët e këtyre pajisjeve të jenë detyrimisht të reja. Për gjithë sa më sipër kërkojmë që të hiqet kërkesa që pjesëtduhet të jenë të reja.***

III.4.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST , Shtojca 6, Formulari i Specifikimeve Teknike, Per te realizuar sistemin e menaxhimit te shërbimit te printimit/fotokopjimit/skanimit kerkohen pajisje me specifikimet te pasqyruara ne specifikimet teknike:

- 14 pajisje printer/fotokopje/skaner A4 Bardhe e zi –  $\geq 30$ ppm
- 3 pajisje printer/fotokopje/skaner A3 full color –  $\geq 40$ ppm

❖ **Specifikimet teknike per pajisjet dhe qe do te perdoren ne kete procedure.**

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Drivers CD:	Po
Software	Portal Web online për monitorimin në rrjet, monitorimin në distancë nëpërmjet Web-it dhe gjenerimin në mënyrë automatike të counter-ave.
Pjesët duhet të jene të reja.	



KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Drivers CD:	Po

Software	Portal Web online për monitorimin në rrjet, monitorimin në distancë nëpërmjet Web-it dhe gjenerimin në mënyrë automatike të counter-ave.
Pjesët duhet të jene te reja	

III.4.2. Komisioni thekson faktin, se specifikimet/kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, të jenë të argumentuara dhe në funksion të objekti dhe qëllimit të procedurës së prokurimit në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Në varësi të objektit të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në LPP vendosja e specifikimeve teknike/kërkesave të veçanta, në rast konkret mbi pjesët e pajisjeve të shërbimit nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është përmbushja me sukses e kontratës dhe kërkesat e veçanta për kualifikim duhet të përcaktohen në varësi të kontratës llojit të objektit të prokurimit dhe volumit të saj.

KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, specifikimi objekt ankimi që Operatorët ekonomikë duhet përdorim pjesw tw reja pwr pajisjet e shërbimit tw printimit është kërkesë e tepruar e cila vendos në vështirësi operatorët ekonomikë e konkretisht përfaqësuesit e biznesit të mesëm dhe të vogël. Gjithashtu Autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë qartë përse është e nevojshme vendosja e një kërkesë mbi pjesët e reja nderkohe që ai nuk ka pajisje për mirëmbajtje por do të përdor 1% pajisje të operatorit për shërbim sikurse edhe ankimesi referuar ankesës argumenton: *[...] kërkesë e AK-së shton kostot e ofertës në mënyrë të panevojshme pasi, ...është e rëndësishme që të marrin shërbimin e printimit, fotokopjimit dhe të skanimit të dokumentave në mënyrë të pandërprerë dhe për të nuk është e rëndësishme nëse pjesët do të jenë të reja apo të përdorura, për sa kohë që është në detyrimin e ofertuesit të garantojë shërbimin në mënyrë të pandërprerë [...]* Komisioni vlerëson ankesën të argumentuar qartë dhe saktë pretendimet e tij, mbi kundërshton specifikimin teknik të vendosur mbi Pjesët e reja për pajisjet, në procedurën e prokurimit Shërbim printimi, ku operatori ekonomik ofron pajisjet e tij për një periudhë kohore të përcaktuar për AK dhe ai është përgjegjës kryesor për mirëfunksionimin e pajisjeve si edhe për mirëmbajtjen e tyre, kryerjen e shërbimeve riparuese apo zëvendësimin e tyre në afatet kohore të përcaktuara nga AK dhe furnizimin e tyre me cdo pjesë të nevojshme me qëllimin final të kryerjes së shërbimit të kërkuar pa ndërprerje në kohë dhe me cilësi.

Akoma më tej Komisioni thekson rolin e Autoriteti kontraktor i cili duhet të hartojë kriteret kualifikuese në përputhje me objektin e prokurimit si edhe momentin e lidhjes së kontratës së shërbimit dhe ekzekutimin e saj ku palët bien dakord mbi të drejtat dhe detyrimet për realizimin e shërbimit me cilësi pa ndërprerje duke monitoruar gjatë gjithë periudhës kohore shërbimin objekt prokurimi.

Përsa arsyetuar Komisioni gjykon të drejta pretendimet e ankimesit ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike duke hequr kërkesën **Pjesët duhet te jene te reja**, nga Shtojca 6 për pajisjet e kërkuara.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Sherbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Sherbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.
4. Autoriteti kontraktor të pasqyrojë ndryshimet dhe sqarimet me shtojcën përkatëse sipas Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij Vendimi.
5. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin brenda 5 ditëve nga publikimi i shtojcës.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për ktimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Anila Malaj

Anëtar  
Gjergj Mersini

Nënkryetar  
Fiorent Zguro

